



## Arkivat: Kapërcimi i hendekut - Thirrje për dorëzimin e temave- Konferenca e ICA's Romë 2022

### FRENGJISHT/ SPANJOLLISHT

Thirrja për dorëzimin e temave për [Konferencën e ICA's, Romë 2022](#) është hapur! Tema për vitin 2022, Arkivat: Kalimi i hendekut, përfshin një gamë të gjerë çështjesh që duhen hetuar, diskutuar dhe hapur ndaj interpretimeve të ndryshme.

#### **Thirrje për dorëzimin e temave**

Ne mirëpresim diskutime në panel dhe prezantime të temave, si dhe propozime për seminare, prezantime të shkurtra, postera dhe formate alternative.

Komiteti i Programit të Konferencës në Romë inkurajon propozime që diskutojnë përgjigje të ndryshme për pyetjet e sugjeruara në secilën nga [nën-temat rreth tejkalimit të boshllëqeve të demokracisë, kulturës, distancës dhe ato digjitale](#). Propozimet që fokusohen në paaftësinë e arkivave për të kapërcyer boshllëqet – apo edhe në mënyrën se si i krijojnë ato – janë gjithashtu të mirëseardhura: qëllimi i konferencës është të sigurojë një forum për diskutimin e pikëpamjeve të ndryshme dhe ndoshta të kundërta.

Propozuesit janë të mirëpritur nga çdo fushë akademike, jofitimprurëse, korporative ose qeveritare brenda ose të lidhura me sektorin e menaxhimit të arkivave dhe dokumenteve në çdo pjesë të botës.

Të gjitha paraqitjet bëhen në mënyrë elektronike nëpërmjet linkut në [ConfTool website](#). Udhëzimet se si të dorëzohen temat gjenden në platformën e dorëzimit.

**Ju lutemi mbani mend se kjo Thirrje do të mbyllet më 21 Mars 2022!**

#### **Më shumë informacion?**

Të gjitha informacionet rreth Thirrjes për dorëzimin e temave mund të gjenden këtu: <http://ica2022roma.com/>

#### **Qëndroni të sintonizuar**

A i keni pëlqyer apo ndjekur tashmë llogaritë e mediave sociale për Konferencën e ICA's Romë 2022? Kontrolloni llogaritë e ICA Roma 2022 në [Twitter](#), [Facebook](#), [LinkedIn](#) dhe [Instagram](#) !

#### **Datat kryesore**

- Hapja e regjistrimit online të konferencës: **1 shkurt 2022**
- Afati i fundit për dorëzimet: **21 Mars 2022**
- Komunikimi për pranimin e dorëzimit: **21 maj 2022**
- Konferenca e ICA's: **21 – 23 shtator 2022**

**#ICARoma2022**

--

**ICA International Council on Archives  
(ICA- Këshilli Ndërkombëtar për Arkivat)**

60, rue des Francs Bourgeois  
75003 PARIS  
FRANCE  
@ICArchiv